



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT
MUAJI DHJETOR 24-36 MUAJ



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

 Fëmijët e Tiranës

<http://femijetiranes.al/>

 femijet_e_tiranes

Kuriozitete për Muajin Dhjetor



Çfarë mund të dimë për Dhjetorin?

- * Muaji dhjetor është **muaji i parë i stinës** së dimrit, kur koha është **shumë e ftohtë** dhe në zonat malore bie borë.
- * Dhjetori është **muaji i fundit** i vitit.
- * Në dhjetor, **ditët janë shumë të shkurtra, ndërsa netët shumë të gjata** dhe të ftohta.
- * Frutat si: **mandarinat, portokallet, shegët, hurmat, gështenjat**, ne i shijojmë në stinën e dimrit.
- * Dhjetori është **muaji i festave të fundvitit** në mbarë botën.

Muaji Dhjetor

Tema: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”

Grupmosha 24-36 muaj

- **Java I** : Karakteristikat e stinës së dimrit.
- **Java II**: Njohja dhe shprehja e emocioneve përmes elementeve stinore.
- **Java III**: Njohja me Festat e Fundvitit dhe përgatitja e dekorit të festave.
- **Java IV**: Programi Festiv i Vitit të Ri.

Tema e Muajit: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”


Tema e Javës	Qëllimi	Koha
Karakteristikat e stinës së dimrit	Njohja me elementët stinorë të dimrit si: moti shumë i ftohtë, reshjet e shiut dhe borës, perimet e frutat e stinës.	Java I
Njohja dhe shprehja e emocioneve përmes elementeve stinore	Të përshkruajmë dhe njohim emocionet bazë, duke i ilustruar me frutat dhe perimet e stinës.	Java II
Njohja me Festat e Fundvitit dhe përgatitja e dekorit të festave	Njohim dhe krijojmë elementët dekorativë të Festave të Fundvitit, ngjyrat dhe format (pema, ylli, kubi, topi, etj).	Java III
Programi festiv i Vitit të Ri	Festojmë së bashku Festat e Fundvitit.	Java IV

- * Stafi edukator duhet të marrë pjesë në çdo aktivitet dhe temë ditore, bashkë me fëmijët.
- * Stafi i praktikon aktivitetet në bazë të zhvillimit dhe interesave të fëmijëve.
- * Stafi duhet të informojë prindërit mbi temën mujore dhe javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.



Tema e Muajit: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”

Tema e Javës: “Karakteristikat e stinës së dimrit”



Java I	Tema	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Natyrë në dimër</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u flet fëmijëve rreth stinës së dimrit dhe muajit dhjetor. Në dimër bën shumë ftohtë, bie borë dhe pemët e rrugët zbardhen; qielli është gri dhe me re. Dhjetori është muaji i parë i stinës së dimrit, por dhe muaji i fundit i vitit.</p> <p>Vjersha: “Bora e bardhë”. Kënga: “Me borën”.</p> <p>Aktivitet: Vrojtjmë nga dritarja stinën e dimrit. Edukatorja ndihmon fëmijët të emërtojnë elementët e stinës, si: retë, era, shiu dhe bora. (Aktiviteti mund të realizohet në oborr, nëse koha është e përshtatshme).</p> <p>Ngjyrosje: Me ndihmën e edukatores, fëmijët, në një tabelë të errët vizatojnë me shkumësa elementët e motit.</p> <p>“Parada në borë”: Me bukëpeshku ose pambuk krijoni një rrugë në të cilën fëmijët të realizojnë një paradë, duke përjetuar “ndjesinë” e dëborës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Tabelë/ dërrasë vizatimi, • Shkumës, • Pambuk, • Bukëpeshku.


<p>E Martë</p>	<p>Njeriu prej Bore</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u flet fëmijëve rreth borës, mbulimit të rrugëve, pemëve dhe gjithçkaje që na rrethon me ngjyrën e bardhë. U shpjegon dhe pyet se ku dhe kur bie më shumë borë. A e keni parë ju borën? A keni luajtur ndonjëherë me të? A keni qenë me prindërit në mal kur ka rënë borë?</p> <p>Vjersha: “Bora e bardhë”/ “Viu viu fryn veriu”.</p> <p>Kënga: “Me borën”.</p>  <p>Aktivitet 1: “Njeriu prej bore” Brenda shisheve të vogla të ujit, fëmijët do të hedhin topa të vegjël prej pambuku. Lidhni një fjongo në mes, i vendosni sytë, hundën dhe gojën me letër adeziv.</p> <p>Aktivitet 2: “Njeriu prej bore” Në një karton të bardhë, edukatorja ka skicuar paraprakisht trupin e njeriut prej bore. Fëmijët i ngjisin kopsat, realizojnë një shall dhe kapuç prej letre dhe e presin së bashku. Secili mund të bëhet një njeri prej bore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kopsa (letër adezive të zezë të prera në formë kopse), • Ngjitëse, • Karton i bardhë, • Shall, • Lapsa me ngjyra, • Shishe uji, • Pambuk, • Fjongo.
<p>E Mërkurë</p>	<p>Veshja e fëmijëve në dimër</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve si vishemi në dimër. Për shkak të të ftohtit, ne veshim rroba të trasha, si: xhup, shall, kapuç, doreza, çizme, etj. Këto rroba na mbrojnë nga i ftohti i dimrit.</p> <p>Vjersha: “Bie bora paf e puf”/ “Bora e bardhë”/ “Viu viu fryn veriu”.</p> <p>Njyrosje: Përgatiten në fletë nga edukatorja, modele të veshjeve të fëmijëve në stinën e dimrit. Fëmijët i ngjyrosin dhe i emërtojnë ato.</p> <p>Punë dore: Në një çarçaf, edukatorja vizaton kapuç, shall, doreza dhe çorape. Fëmijët, me ndihmën e edukatores, i presin ato me gërshtë, i ngjyrosin me lapustila/ penela dhe i ngjisin në një karton.</p> <p>Përralla: “Mamadhia dhe shtatë kecat”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Libër me përralla, • Çarçaf i bardhë ose mbulesë, • Karton, • Lapustila ose bojëra.

<p>E Enjte</p>	<p>Veshja e Kukullës</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve sesi e veshim kukullën në dimër dhe se cilat janë veshjet e duhura.</p> <p>Aktivitet: Edukatorja, bashkë me fëmijët, tregojnë veshjen e kukullës me rroba të trasha, si: shalli, dorezat, kapelet, kapuçi, papuçet.</p> <p>Vjersha: “Muaji Dhjetor”.</p> <p>Kënga: “Me borën”.</p> <p>Lojë energjike: Me litarë ose me rrathë (Fëmijët ndahen në grupe).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kukull, • Veshje të vogla bebesh, • Shall, • Doreza, • Kapuç, • Çorape.
<p>E Premte</p>	<p>Përsëritja e aktiviteteve të javës</p> 	<p>Bisedë: Përsëritja e elementëve të mësuara gjatë javës.</p> <p>Vjersha: “Muaji Dhjetor”/ “Bie bora paf e puf”/ “Bora e bardhë”/ “Viu viu fryn veriu”.</p> <p>Kënga: “Me Borën”.</p> <p>Përrallë e lirë: Edukatorët ilustronë me anë të figurave (sipas librave që disponojnë në grup).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Libër me përralla.





Tema e muajit: “Karakteristikat e stinës së dimrit dhe përgatitja për Festat e Fundvitit”

Tema e Javës: “Njohja dhe shprehja e emocioneve përmes elementëve stinorë”



Java II	Tema	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Frutat e stinës dhe emocionet</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve përmes modeleve vizive/ tablove frutat e stinës si: portokalli, manderina, limoni, kivi, hurma, gështenja, shega.</p> <p>Vjersha: “Etika e ushqimit”/ “Perimet më bëjnë të fortë”.</p> <p>Aktivitet: Edukatorët skicojnë disa fruta të stinës dhe i ndihmojnë fëmijët të realizojnë emocionet bazë brenda figurave. Pasi të kenë realizuar emocionin e dëshiruar, fëmijët mund të ngjyrosin frutat.</p> <p>Aktivitet krijues: Prisni në pjesë të vogla pipëza (ose përdorni kopsa) me ngjyra të ndryshme dhe fëmijët t’i kombinojnë ato duke i kaluar në fije të trasha peri.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fruta të stinës, • Fruta të printuara, • Letra të bardha, • Lapsa me ngjyra, • Kopsa ose pipëza, • Spango (pe i trashë).


<p>E Martë</p>	<p>Perimet e stinës dhe emocionet</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve përmes modeleve/ figurave perimet e stinës, si: lulëlakra, brokoli, fasulet, thjerrëzat, spinaqi, karrotat, rrepat, etj.</p> <p>Vjersha: “Perimet më bëjnë të fortë”/ “Karrota”.</p> <p>Aktivitet: Edukatorët skicojnë/ printojnë disa perime të stinës dhe i ndihmojnë fëmijët të vizatojnë emocionet bazë brenda figurave. (Nëse perimet i keni printuar në letër me ngjyrë, ndihmojini fëmijët t’i presin ato dhe t’i ngjisin në letër kartoni).</p> <p>Lojë: Vendosni në dyshe me katër kartona me ngjyra të ndryshme (e bardhë, blu, e gjelbër, e kuqe) dhe fëmijët të vizatojnë mbi to një emocion të caktuar.</p> <p>Përrallë: “Rrepa”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Perime të stinës, • Perime të printuara, • Gërshërë, • Letër, • Lapsa me ngjyra.
<p>E Mërkurë</p>	<p>Përgatitja e ushqimeve në format e emocioneve</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u flet fëmijëve për dobinë e konsumimit të frutave dhe perimeve, sa mirë i bëjnë trupit të tyre dhe se sa të shijshme janë ato.</p> <p>Vjersha: “Perimet më bëjnë të fortë”/ “Karrota”.</p> <p>Aktivitet: Krijojmë së bashku me fëmijët në pjata emocione dhe figura të ndryshme. Përdorni sa më shumë fruta dhe perime të stinës, për të realizuar figurat. Duke realizuar punimet, edukatorët u flasin fëmijëve për llojin e frutit/perimes dhe sa krijime të veçanta mund të bëjnë, përveçse t’i konsumojnë.</p> <p>Lojëra të lira, kërcim.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fruta të stinës, • Perime dhe fruta të stinës, • Pjata. 



<p>E Enjte</p>	<p>Panairi i frutave dhe perimeve të stinës</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja pyet fëmijët: Cilat janë frutat dhe perimet e stinës? Çfarë ngjyre kanë ato? Çfarë emocionin ndieni kur i konsumoni ato?</p> <p>Aktiviteti: Edukatorja u shpjegon fëmijëve që përdorimi i lëngjeve të ngrohta në stinën e dimrit ndihmon për të na mbrojtur nga i ftohti dhe virozat e stinës. Aktivitetet që mund të realizohen:</p> <p>-Mund të përgatitet nga kuzhina çaj dhe të serviret në grup. -Mund të përgatitet lëng me fruta të stinës (të sjella nga fëmijët atë ditë) nga kuzhinierja në prani të fëmijëve.</p> <p>“Panairi i frutave dhe perimeve” Gjatë javës, edukatorët të kenë informuar prindërit rreth panairit dhe të bashkëpunojnë për të sjellë fruta dhe perime të stinës ose ëmbëlsira të përgatitura me fruta të stinës së dimrit (p.sh. kek me portokalle). Demonstrimi realizohet me konceptin e ngjyrës, sipas kategorisë fruta/perime.</p> <p>Loja energjike: Me litar (ndarja në dy grupe).</p>	 
<p>E Premte</p>	<p>Punë dore e frutave dhe perimeve të stinës</p> 	<p>Punë dore: “Kopshti i frutave dhe perimeve” Fruta dhe perime të printuara i prisni dhe ngjitini në shkopinje të krijuar prej letre/kartoni. Vendosni sfungjer në një karton të prerë, ku fëmijët të vendosin frutat, perimet sipas dëshirës.</p> <p>Lojë shpejtësie: Vijëzoni me shiritat dy modele të ndryshme rrugë, njërin me zigzake rrethore, tjetrën katrore dhe në fund, vendosni nga një fruit/perime në secilën. Fëmijët duhet të ndjekin trajektoren e vijëzuar dhe të ulen për të kapur objektin.</p> <p>Përralla: “Kësulkuqja”. (Edukatorja nxit fëmijët të shpjegojnë frutat dhe perimet në shportën e Kësulkuqes me qëllim lidhjen e fruta/perimeve të stinës, të mësuara gjatë javës).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Karton • Fruta,perime të printuara, • Sfungjer, • Lapustila, • Gërshërë, • Libër me përralla.


Tema e Muajit: “Karakteristikat e stinës së dimrit dhe përgatitja për Festat e Fundvitit”


Tema e Javës: “Njohja me Festat e Fundvitit dhe përgatitja e dekorit”



Java III	Tema	Aktivitetet	Mjetet
E Hënë	<p>Njohja me elementët dekorues të festës së Vitit të Ri</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve se dhjetori është muaji i fundit i vitit. Këtë muaj festojmë ardhjen e Vitit të Ri dhe me ardhjen e tij ne dekorojmë ambiente të ndryshme, si: shtëpia, çerdhja, rrugët e qytetit dhe vitrinat e dyqaneve. Së bashku me fëmijët gjejmë dhe emërtojmë objekte identifikuese të festës, si: pema, shirita shumëngjyrshë, yje, drita, etj.</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”/ “Muaji Dhjetor”.</p> <p>Këngë: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p> <p>Punë dore: Edukatorët, së bashku me fëmijët marrin fletë punëdore (me ngjyra), i prisni dhe realizoni shirita</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Letra me ngjyra • Gërshërë • Ngjitës • Fletë punëdore • Letër e bardhë • Pambuk

		<p>shumëngjyrësh për të zbukuruar grupin.</p> <p>Aktivitet: Vizatoni në fleta një fytyrë babagyshi dhe ndihmohuni fëmijët të ngjisin në të kapuçin e prerë në ngjyra të ndryshme, ndërsa mjekrën/majën e kapuçit ta ngjisin me pambuk ose material të ngjashëm.</p>	
E Martë	<p>Bredhi i Vitit të Ri</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se do të zbukurojnë bredhin. Edukatorja stimulon fëmijët të emërtojnë ngjyrat e elementëve dekorues, si: topat, ylli, shiritat, etj.</p> <p>Vjersha: “Bie bora paf e puf”/ “7 dhuratat”/ “Muaji Dhjetor”.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p> <p>Aktivitet i lirë: Fëmijët, së bashku me edukatoren, zbukurojnë bredhin duke vendosur elementët dekorues festivë.</p> <p>Loja: “Zhvillojmë konceptin lart-poshtë”</p> <p>Një pjesë të sendeve dekoruese i lini poshtë pemës dhe kërkojuni fëmijëve të gjejnë të ngjashmen/ njëjtën me atë të bredhi. Pasi e identifikojnë e pyesim: A është i njëjti top me atë të pemës? Ku është ylli, fëmijë? Po ky shiriti këtu, ku është, poshtë apo lart?</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Manuali i Vjershave • Pema e Vitit të Ri • Dekore të pemës
E Mërkurë	<p>Përgatitja e dhuratave</p> 	<p>Aktivitet: Edukatorja së bashku me fëmijët përgatisin dhurata. Kuti të gatshme me përmasa të ndryshme i veshim me një paketim festiv (Përdorim letra të shndritshme dhe me ngjyra të ndryshme).</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p> <p>Lojë: “Koncepti i madh-i vogël”</p> <p>Me dhuratat e paketuara ose zbukurimet e pemës stimulon fëmijët t’i grupojnë ato në objekte më të vogla dhe më të mëdha. (Nëse do të përdorni vetëm kutitë e paketuara ose topat dekorues mos përfshini lodrat e ndryshme në formë, pasi fëmijët mund të ngatërrojnë madhësisë dhe formën).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kuti kartoni • Letra me ngjyra të shndritshme • Fjongo zbukurimi.


<p>E Enjte</p>	<p>Përgatitja e kapeleve të Vitit të Ri</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se do të përgatisin së bashku kapelet për Vitin e Ri dhe u tregon atyre një kapelë.</p> <p>Aktivitet i orientuar: Duke përdorur materiale të riciklueshme, si kartona, fije peri me ngjyra, letra me ngjyra, etj., fëmijët së bashku me edukatoren, ngjyrosin, presin materielet e punuara dhe ngjisin disa elementë festivë në kapelet e krijuara.</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”/ “Muaji Dhjetor”</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kartona, • Fije peri me ngjyrë /shirita të hollë, • Gërshërë, • Ngjitës, • Lapustila.
-----------------------	--	--	---



<p>E premtë</p>	<p>Përgatitja e kartolinave të urimit</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se do të përgatisin së bashku kartolinat për Vitin e Ri dhe demonstron një kartolinë. Pyetini fëmijët rreth urimit që duan të shkruajnë në kartolinë.</p> <p>Aktivitet: Duke përdorur materiale të riciklueshme, si: kartona, fije peri me ngjyra, letra me ngjyra, etj. fëmijët së bashku, me edukatorët ngjyrosin, presin materiet e punuara dhe ngjisin disa elementë festivë në kartolinat e krijuara.</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”/ “Muaji Dhjetor”.</p> <p>Kënga: “ Ja na erdhi Viti i Ri”.</p> <p>Këngë lëvizore: “Koka, krahët, duart poshtë”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kartona • Fije peri me ngjyrë /shirita të hollë. • Gërshërë • Ngjitës • Lapustila
------------------------	--	---	---



Tema e Muajit: “Karakteristikat e stinës së dimrit dhe përgatitja për Festat e Fundvitit”

Tema e Javës: “Programi festiv i Vitit të Ri”



Java IV	Tema	Aktivitetet	Mjetet
<p>E Hënë</p>	<p>Dekorimi i mjedisit të grupit</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja i`u flet fëmijve rreth mënyrës se si do të dekorojnë grupin për festën e ditëve në vijim. Gjejnë së bashku sendet që i duhen festës si; një skenë e vogël për recitim e këngë, shirita shumë ngjyrës, pema e vitit të ri, veshja e duhur e fëmijve, dhuratat, babagyshi, mikrofon etj.</p> <p>Vjersha: “7 Dhuratat”/ “Vjersha për stinën e dimrit”/ “Bora e bardhë”/ “Viu, viu, fryn veriu”.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p> <p>Aktivitet i orientuar: Së bashku me fëmijët krijoni një mjedis të vogël në grup ku do të realizohet festa, realizoni me punime dore nga fëmijët, demonstroi qëndrimin e tyre në skenë duke ndihmuar në recitimin e vjershave dhe këndimin e këngëve.</p> <p>Punë dore: Vizatimi i lirë dhe punime me ngjitje me temën e festave.</p> <p>Lojë me rrathë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shirita me ngjyra • Zbukurime të ndryshme • Lapustila • Gërshtë • Letër e bardhë.

<p>E Martë</p>	<p>Përgatitja e vjershave dhe këngëve</p> 	<p>Aktivitet festiv në grup: Edukatorja së bashku me fëmijët përgatisin në grupe programin festiv.</p> <p>Vjersha: “7 Dhuratat”/ “Vjersha për stinën e dimrit”/ “Bora e bardhë”/ “Viu, viu, fryn veriu”/ “Bie bora paf e puf”.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p> <p>Punë dore: Vizatim i lirë dhe punime ose ngjitje me temën e festave.</p> <p>Lojëra të lira dhe kërcim.</p>	<p>Manuali i vjershjave dhe këngëve.</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Përgatitja e vjershave dhe këngëve</p> 	<p>Aktivitet festiv në grup: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin në grupe programin festiv.</p> <p>Vjersha: “7 Dhuratat”</p> <p>Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit”,</p> <p>Vjersha: “Bora e bardhë”</p> <p>Vjersha: “Viu viu fryn veriu”</p> <p>Vjersha: “Bie bora paf e puf”</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi viti i Ri”</p> <p>Vizatim/ Ngjyrosje/ Punim me plastelinë: “Elementë të Vitit të Ri”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Plastelinë • Lapustila • Fletë të bardha

<p>E Enjte</p>	<p>Përsëritja e vjershave dhe këngëve</p> 	<p>Përsëritje e programit festiv.</p> <p>Me fëmijët përsërisni vjershat dhe këngët që kemi mësuar gjatë muajit dhe do t'i përdorni për koncertin festiv. Stimuloni fëmijët të recitojnë e këndojnë në kor.</p> <p>Bisedë me prindërit:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Veshja festive e fëmijës për festën e vitit të Ri (përgatitje për festën e ditës së nesërme) - Dhurata që prindi dëshiron të sjellë për fëmijën e tij. 	
<p>E Premte</p>	<p>Festa e Vitit të Ri</p> 	<p>Realizimi i programit festiv</p> <p>Shpërndarja e dhuratave</p>	